

## **Kushtet të Veçanta për Sigurimin e Jetës në Grup në Rast të Vdekjes – DL061008**

### **Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme**

1. Kushtet e Përgjithshme për Sigurimin e Jetës, në vazhdim Kushtet e Përgjithshme, dhe këto Kushte të Veçanta për Sigurimin e Jetës në Grup në Rast të Vdekjes, në vazhdim Kushtet e Veçanta, janë pjesë përbërëse e kontratës për sigurimin e jetës të cilin Kontraktuesi i Sigurimit e nënshkruan me siguruesin.
2. Grup do të thotë të gjithë personat, që kanë marrëdhënie të përbashkët me Kontraktuesin e Sigurimit.
3. Sipas këtyre Kushteve të Veçanta mund të sigurohen, bashkërisht, të gjithë anëtarët e grupit. Siguruesi është i obligueshëm ti pranojë në sigurim të gjithë anëtarët e grupit me kushte të njëjta duke mos marrë parasysh gjendjen shëndetësore të ndonjërit nga personat.
4. Pjesë përbërëse e ofertës për sigurim është lista e të gjithë anëtarëve të grupit me të dhënat mbi gjininë, datën e lindjes, lartësinë e shumës së siguruar, Përfituesit dhe nënshkrimet e anëtarëve të grupit.
5. Kontraktuesi është i obliguar që rregullisht ta njoftojë Siguruesin mbi ndryshimet në grup (kyçja në sigurim e anëtarëve të ri të grupit dhe largimi i atyre që lëshojnë grupin).

### **Neni 2 - Rasti i Siguruar**

1. Sipas këtyre të Kushteve të Veçanta kontraktohet sigurimi i anëtarëve të grupit për rast të vdekjes gjatë kohëzgjatjes së sigurimit.

### **Neni 3 - Llogaritja e Primit**

1. Primi për një anëtar të grupit caktohet në baza mujore dhe është unik për të gjithë anëtarët e grupit. Llogaritet në bazë të moshës mesatare të grupit, ku me rastin e kalkulimit të moshës mesatare moshë për femra zvogëlohet për tre vite.
2. Në rast të ndryshimeve në strukturë të grupit, Kontraktuesi dhe Siguruesi kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin e lartësisë së primit deri në skadimin e vitit, për të cilin është caktuar primi më herët.
3. Primi për grupin llogaritet si shuma e primit të gjithë anëtarëve të grupit. Primi paguhet paraprakisht në afatet e kontraktuara deri në

skadim të sigurimit, e në rast të vdekjes së anëtarit të grupit gjatë periudhës së sigurimit, herën e fundit për periudhën në të cilën anëtari i grupit ka vdekur.

4. Kontraktuesi është i obliguar ta paguaj primin. Me miratim të Siguruesit një pjesë e primit mund të paguhet nga çdo anëtarë i grupit. Nëse ndonjë pjesë e primit paguhet ndaras nga çdo anëtar i grupit, primi llogaritet me tarifë tjetër.

### **Neni 4 - Obligimet e Siguruesit**

1. Në rast të vdekjes së anëtarit të grupit gjatë kohëzgjatjes së sigurimit, Përfituesit të cekur në policë i paguhet:
  - a. 50% nga shuma e siguruar, nëse vdekja ka ndodhur në 6 mujorin e parë nga përfshirja në sigurim e atij anëtari të grupit
  - b. Shuma e siguruar, nëse vdekja ndodh pas 6 muajsh nga pranimi në sigurim të atij anëtari të grupit
2. Me përjashtim nga paragrafi a. i pikës 1. të këtij neni, shuma e siguruar i paguhet tërësisht Përfituesit nëse:
  - a. Kontraktimi i sigurimit është bërë me kontroll paraprake mjekësore të atij anëtari të grupit
  - b. Vdekja ka ndodhur si pasojë e aksidentit, në kuptim të Kushteve të Veçanta për Sigurimin Shtesë nga Aksidentet Personale
  - c. Vdekja ka ndodhur si pasojë e shtatzënisë apo gjatë lindjes
3. Me përjashtim nga paragrafi a. i pikës 1. të këtij neni, nëse kontrata për sigurim është nënshkruar në afat prej 30 ditësh nga data e përfundimit të sigurimit të mëparshëm me Siguruesin, dhe vdekja nuk ka ndodhur si pasojë e rrethanave të cekura në pikën 2. të këtij neni, atëherë Përfituesit i paguhet 50% e shumës së re të siguruar ose 50% e shumës së siguruar nga sigurimi i mëparshëm, varësisht se cila është më e lartë, por nuk mund të tejkalojë 100% të shumës së re të siguruar.

## **Neni 5 - Zbatimi i Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës**

1. Në kontratat për sigurim të nënshkuara me këto Kushte të Veçanta zbatohen nenet e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës.
2. Nëse ka ndonjë mospërputhje në mes të ndonjërës nga dispozitat e Kushteve të Përgjithshme për Sigurimin e Jetës dhe ndonjërën nga dispozitat e këtyre Kushteve të Veçanta, në marrëdhëniet nga kontrata për sigurim do të zbatohen dispozitat nga këto Kushte të Veçanta.